

## UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 8451/4, datë 5.1.2015

### **PËR CAKTIMIN E ÇMIMIT DHE TARIFAVE TË BOTIMEVE TË QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE, SI DHE INSTITUCIONET QË PËRFITOJNË FALAS KOPJE TË BOTUARA TË FLETORES ZYRTARE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 16, pika 4, të ligjit nr.78/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave

#### UDHËZOJNË:

1. Çmimi i shitjes së botimeve (përfshirë edhe Fletoren Zyrtare) llogaritet si prodhim i çmimit për një faqe, me numrin e faqeve të botimit. Çmimi për një faqe është 7 (shtatë) lekë.
2. Për botimet me lidhje speciale, çmim total i botimit do të jetë i barabartë me çmimin e rezultatit të prodhimit (7 lekë për nr. faqesh) plus 300 lekë.
3. Çdo subjekt i interesuar mund të bëjë abonim vjetor pranë “Posta Shqiptare” sh.a.
4. Botimet (përfshirë edhe Fletoren Zyrtare) mund të shiten drejtpërdrejt nga Qendra Botimeve Zyrtare me çmimin e vendosur në kapak. Pagesa bëhet në llogarinë bankare zyrtare të Qendrës.
5. Çmimi i abonimit vjetor pranë “Posta Shqiptare” sh.a., për Fletoren Zyrtare, është 20 000 (njëzet mijë) lekë.
6. Çmimi i shitjes së botimeve për libraritë dhe agjencitë shpërndarëse llogaritet me një zbritje prej 5% mbi çmimin e llogaritur sipas pikës 1, të këtij urdhri (kur ky aktivitet pasqyrohet në objektin e aktivitetit tregtar të këtij subjekti tregtar).
7. Çmimi i shitjes së serive të Fletoreve Zyrtare në CD-ROM për secilin vit, është 5000 (pesë mijë) lekë.
8. Konsultimi i akteve të botuara në Fletoren Zyrtare në faqen zyrtare të internetit është falas.
9. Për konfirmimet dhe kopjet e akteve të caktuara, do të zbatohet çmimi 20 (njëzet) lekë për fletë.
10. Për shumëfishime të Fletores Zyrtare të numrave të kaluar, jashtë tirazhit të përcaktuar, do të zbatohet çmimi 20 (njëzet) lekë për faqe.
11. Shpërndarja e Fletores Zyrtare, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë realizohet me kontratë me “Posta Shqiptare” sh.a., e cila mban 10% të vlerës së abonimit.
12. Institucionet që përfitojnë falas kopje të botuara të Fletores Zyrtare, janë ato të përcaktuara sipas ligjeve të posaçme.  
Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË  
**Nasip Naço**

MINISTRI I FINANCAVE  
**Shkëlqim Cani**